



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

1	Data	07.08.2026	Vendi	KAÇANIK ²
Nj. org.	Numri	Shtojcë		
01	370/21-2025	✓		

KONTRATA PËR PUNË

Komuna e Kaçanikut (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), i përfaqësuar nga **z.Izahir Kuka**, UD.Menaxher i prokurimit; në njërën anë dhe

"N.T.SH AR-DRITI" nga Ferizaj (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), i përfaqësuar nga **z.Nehat Dalloshi** në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

Rregullimi i parmakëve në stadiumin Besnik Begunca

Me nr të prokurimit: **652-26-5877-5-3-6**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: **Rregullimi i parmakëve në stadiumin Besnik Begunca**

1.2 Kontrata hynë në fuqi **07.08.2026**

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se **20 ditë** nga data e nënshkrimit të kontratës

1.4 Vendi **Stadiumi Besnik Begunca, Kaçanik**

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë **DDP¹** (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë **LPP-04/L-042**. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **7,776.50 €; me fjalë (Shtatë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë euro, e pesëdhjetë cent)**

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas bersës përkatëse).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro në llogarin Bankare).

Autoriteti Kontraktues do të paguaj OE dhe atë pas pranimit të punëve nga na e menagjerit të projektit si dhe komisionit për pranim të punëve

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i punëve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 00 muaj, pas pranimit të **punëve**.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin **[t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] [të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet] [te kryej ndonjë ose të gjitha punët]** brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së **[furnizimeve] [punëve] [shërbimeve]** të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e

res-judikata; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e res judicata për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në gjykatën komunale në Kaçanik në pajtim me ligjin e Kosovës.


Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën [Shqip] [Serbisht] [Anglisht] ² në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Nehat Dalloshi	Emri:	Izahir Kuka
Pozita:	Drejtor	Pozita:	Menagjer i Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	07.08.2026	Data:	07.08.2026
Vula:		Vula:	

PARAMASA DHE PARALLOGARIA					
Rregullimi i paramarkëve në Stadlumin "Besnik Begunca"					
Nr.	Pozicionimi	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Vlera (€)
1.0	Punët e paramarkëve				
1.1	Furnizimi dhe montimi i rrjetës metalike të plastifikuar me trashësi 3-4mm, hapja e rrjetës 7.0x7.0 cm e lidhur në profilat e konstruksionit të çelikut. Lartësia e rrjetës mbrojtëse në pjesën lart të tribunave të jetë në lartësi jo më të vogël se 2m. Në pozicion hyjn edhe ankerimet, lidhjet e nevojshme për shtangim.	m²	132.00	10.00	1320.00
1.2	Furnizimi me material dhe punimi i paramarkëve për tribunat me material metalik me Tub Ø48.3x2, në këtë pozicion përfshihet dhe ankerimi me pllakë metalike 10mm si dhe ankerimi i tyre. Në llogari hyjnë edhe shtangimi me ankera të nevojshëm. Ngjyrosja e paramarkëve me një shtresë ngjyrë për mbrojtje ndaj korozionit dhe dy shtresa ngjyrë të yndyrshme	m²	74.00	50.00	3700.00
Gjithsej 1					5020.00

Nr.	Pozicionimi	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Vlera (€)
2.0	Punët e Kabinës				
2.1	Furnizimi dhe montimi i Kullës do të jetë me konstruksion çeliku S235JR, me lartësi totale 6.00 m, platformë pune në kuotën +5.00 m me dimensione 2.00 x 2.00 m, e pajisur me paramark mbrojtës me lartësi 1.10 m dhe shkallë metalike me gjerësi 0.80 m. Konstruksioni përbëhet nga shtylla kryesore prej profili SHS 100x100x5 mm, trarë horizontalë RHS 80x40x4 mm, diagonale stabilizuese SHS 50x50x4 mm, si dhe platformë me grilë metalike galvanizuar antirrëshqitëse. Në llogari hyjnë të gjitha punët ndërlidhëse deri në kompletim të kabinës (kullës) për kamera.	kg	1200.00	2.00	2400.00
2.2	Furnizimi dhe montimi i Kabinës metalike me përmasa 1.50 x 1.20 x 2.20 m, i ndërtuar me konstruksion çeliku nga profile katrore 30x30x2 mm. Muret dhe kulmi realizohen me panele, të cilat sigurojnë mbrojtje nga shiu, era dhe rrezet e diellit. Dysheja përbëhet nga kornizë metalike me pllakë 18 mm, të gjitha elementet metalike lyhen me bojë antikorrozive.	kg	230.00	1.55	356.50
Gjithsej 1					2756.50

REKAPITULIM			
1	Punët e paramarkëve		5020.00
2	Punët e Kabinës		2756.50
Total:			7776.50

Punëkryersi duhet të jetë në kordinim të plotë me Menaxherin e Kontratës deri në përfundim të të gjitha detajeve, dhe gjatë gjdo dëmtimi rreth kryerjes së punëve duhet të sanohet nga OE. Detajet e punëve vendosen nga Menaxheri në kordinim dhe bashkpunim me punëkryersin.





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF
KOSOVO
Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik/Municipality of Kačanik



KRYETARI I KOMUNËS
01 Nr. 370/01-20855
Kaçanik, 07.08.2026

Në bazë Ligji Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
I ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 të
Rregullores 001/2022 Për Prokurimi Publik nenit 70 , Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
PËR EMËRIMIN E MENAXHERIT TË PROJEKTIT

I. Me këtë vendim emërohet Menaxher i projektit **Shkodran Sopa** në projektin: **”Rregullimi i
parrmakëve në stadiumin Besnik Begunca”**. Në bazë të kontratës **01NR.370/01-20855** të datës
07.08.2026

II. Menaxheri i projektit do të jetë përgjegjës për menaxhimin e projektit të lartpërmendur,
do të raportoj me shkrim ZKA, Zyren e Prokurimit, **DKRS** mbi realizimin e punëve në teren.

III. Sipas këtij vendimi Menaxherët e projektit do të jenë të angazhuar në procesin e
implementimit të projektit, bazuar në përgjegjësit sipas LPP-se dhe Rregullores së Prokurimit
Publik.

IV. Me këtë vendim të njoftohet: Menaxheri, Zyra e prokurimit , OE dhe **DKRS**

Kryetari i komunës
Z. Sabedin Vishi

